

Njoftim mbi të Drejtat e Subjektit për të Dhëna Personale

Qëllimi dhe fushëveprimi i njoftimit:

Me këtë njoftim KRK ju informon për angazhimin dhe përkushtimin e saj, në mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave tuaja personale. Ne jemi përgjegjës për të dhënat personale të cilat i mbledhim nga ju, andaj në vazhdim të këtij njoftimi ju do të informoheni se çfarë të dhëna personale i mbledhim, qëllimet e përdorimit të atyre të dhënave, me kënd i ndajmë ato të dhëna personale, sa gjatë i mbajmë ato, si dhe për të drejtat e juaja si subjekt i të dhënave personale.

Informatat të cilat mblidhen nga KRK nga ju kanë të bëjnë me:

- **Informacione bazë të identifikimit:** Është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose i identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social. Ne përpunojmë këto të dhëna në mënyrë që të përpilojmë marrëveshjen për kredi apo dokumente tjera të nevojshme. Si informata identifikuese personale kategorizohet: emri dhe mbiemri, numri i identifikimit, letërnjoftimi/pasaportës, vendi dhe data e lindjes, gjinia.

- **Informacione socio-demografike dhe të punësimit:** Në përputhje me menaxhimin e rrezikut kreditor për aprovimin e kredisë suaj ne kërkojmë këto informacione si: informacionet tuaja rreth vendbanimit, të ardhurat e rregullta mujore, burime tjera e të ardhurave, numrin e personave të cilët janë të ndikuar nga të ardhurat e juaj, kualifikimet/titulli profesional, kualifikimet profesionale, të dhënat rreth viteve të përgjithshme të punësimit, lloji i punësimit.

- **Informacione rreth gjendjes familjare:** Ne mbledhim të dhëna rreth gjendjes familjare me qëllim të njohjes së klientit nëpërmjet këtyre informacione: statusi martesor, numrin e anëtarëve të familjes, numrin e anëtarëve të familjes të cilët janë të punësuar, numrin e anëtarëve të familjes të cilët punojnë jashtë vendit.

- **Informacione kontaktuese:** Qëllimi i mbledhjes së këtyre informacioneve kontaktuese është në raste kur kemi të bëjmë me njoftimin për ndryshimet e kontratës, kushteve apo termave të përgjithshëm, njoftimin në rast se kredia juaj nuk është realizuar sipas afatit të maturimit, apo bisedimin e masave lehtësuese në raste kur ka vështirësi në pagesa etj. Si informacione kontaktuese konsiderohen: numri i telefonit (mobil apo fiks), e-mail, adresa e banimit.

- **Informacione që ndërlidhen me klientin:** Ne përpunojmë të dhëna që kanë të bëjnë me të dhënat tuaja bankare dhe financiare, të dhënat që lidhen me shprehitë dhe preferencat tuaja, të dhëna nga ndërvëprimet tuaja me ne në degët tona, faqet tona të internetit, me takimet, thirrjet, bisedat, e-mail e shkëmbyer, intervistat, bisedat telefonike si dhe të dhëna që lidhen me aktivitetet e lira dhe interesat tuaja.

Qëllimet për të cilat përdoren të dhënat tuaja janë për ti përmbushur detyrimet tona konform ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, duke përfshirë:

- **Rregulloret bankare dhe financiare të aplikueshme për institucionet mikrofinanciare**

- **Realizimin e një kontrate me ju ose për të ndërmarrë hapa sipas kërkesës suaj para lidhjes së një kontrate, këto të dhëna përdoren në mënyrë që: të ju ofrojmë informata lidhur me produktet dhe shërbimet**

tona, të ju ndihmojmë dhe përgjigjemi në kërkesat tuaja, të vlerësojmë nëse mund të ju ofrojmë një produkt ose shërbim dhe në cilat kushte dhe të ofrojmë produkte ose shërbime për klientët tanë

• **Përmbushjen e interesit tonë legjitim** ne përdorim të dhënat tuaja personale për të shpërndarë dhe zhvilluar produktet ose shërbimet tona, për të përmisuar menaxhimin e rrezikut dhe për të mbrojtur të drejtat tona ligjore, duke përfshirë: Dëshminë e transaksioneve, parandalimin e mashtrimit, trajnimin e stafit tonë, menaxhimin e TI-së,

• **Personalizimin e ofertës sonë përmes:** përmirësimin e shërbimeve tona, reklamimin e produkteve ose shërbimeve tona financiare, reklamimin e produkteve dhe shërbimeve që përputhen me gjendjen dhe profilin tuaj, segmentimin e klientëve tanë dhe klientëve të mundshëm, apo fushatë tjetër të ngjashme marketingu dhe menaxhimi të ngjarjes, komunikimi për produktet, shërbimet, ofertat, lajmet tona, shërbimi ndaj klientit , duke përfshirë përgjigjet në pyetjet tuaja, përmirësimi dhe personalizimi i përvojës tuaj në uebfaqet dhe aplikacionet tona, mirëmbajtja e llogarisë kreditore duke përfshirë administrimin e çdo programi lidhur me besnikërinë ose shpërblimin e klientit.

• **Respektimin e zgjedhjes tuaj** nëse kemi kërkuar pëlqimin tuaj për një procesim/ përpunim të të dhënave tuaja personale specifik, në raste të caktuara, si:

✓ kur qëllimet e mësipërme të çojnë në vendimmarrje të automatizuar e cila prodhon efekte ligjore ose që ndikon dukshëm në ju. Në atë moment ne do t'ju informojmë ndarazi për logjikën e përfshirë si dhe rëndësinë dhe pasojat e parashikuara të përpunimit të tillë.

✓ Nëse ne duhet të bëjmë përpunim të mëtejshëm për qëllime tjera nga ato të mësipërme ne do t'ju informojmë ju dhe , aty ku është e nevojshme, të marrim pëlqimin tuaj.

Për të përmbushur qëllimet e lartpërmendura, ne shpalojmë të dhënat tuaja personale tek: ofruesit e shërbimeve që kryejnë shërbime në emrin tonë, autoritetet financiare ose gjyqësore, agjencitë shtetërore ose organet publike, sipas kërkesës dhe në masën e lejuar me ligj, si dhe disa profesionistë rregullativë si avokatët, noterët, auditorët e jashtëm, përmbaruesit.

Të dhënat personale ne i mbajmë: për një periudhë e cila është në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, dhe më pas ato do ti fshijmë apo do ti bëjmë anonime, nëse kjo nuk është e mundur atëherë ato do të izoloohen derisa fshirja të jetë e mundur.

Të drejtat e subjektit të të dhënave: Sipas Ligjit Nr. 06/L-082 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, këto janë të drejtat e subjektit të të Dhënave

- E drejta për t'u informuar subjekti i të dhënave
- E drejta për qasje nga subjekti i të dhënave
- E drejta për korrigjimin e të dhënave
- E drejta për fshirjen e të dhënave
- E drejta për të kufizuar përpunimin e të dhënave
- E drejta e transferimit të të dhënave
- E drejta për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave
- E drejta për vendimmarrjen e automatizuar individuale, duke përfshirë profilizimin.

E drejta për t'u informuar: Ju keni të drejtë të informoheni se si KRK-ja përpunon të dhënat tuaja dhe arsyet për përpunimin e të dhënave. Për të siguruar këtë informacion, KRK ka për detyrë të ju njoftoj se cilat të dhëna mbledhen për ju, se si dhe përpunohen ato, si dhe bazën ligjore që e rregullon përpunimin e të dhënave personale. Ju mund të merrni një kopje të njoftimit lidhur me të drejtat e juaja, pa asnjë kosto.

E drejta e qasjes: Ju si subjekt i të dhënave ju takon e drejta e qasjes në të dhënat tuaja personale të cilat mbahen nga KRK.

E drejta për korrigjimin e të dhënave: Një nga parimet themelore që mbështesin mbrojtjen e të dhënave është se të dhënat që KRK-ja përpunon për ju do të jenë të sakta. Ju keni të drejtë të korrigjoni të dhënat

tuaja nëse janë të pasakta ose jo të plota. Korrigjimi mund të behet pas kërkesë suaj nga KRK në afatin e parapare ligjore.

E drejta për fshirjen e të dhënave: Subjekti i të dhënave ka të drejtë të kërkojë fshirjen e të dhënave të tij nga sistemet e KRK-s, kur KRK nuk ka arsye të vazhdojë të përpunoj me tutje të dhënave të tij. Ju si subjekt i të dhënave keni të drejtë të kërkonit fshirjen e të dhënave tuaja në rrethanat e mëposhtme:

- kur të dhënave personale nuk janë më të nevojshme në lidhje me qëllimin për të cilin KRK fillimisht i ka mbledhur ose përpunuar ato.
- kur ju keni tërhequr pëlqimin tuaj për përpunimin e më tutjeshëm të të dhënave dhe nuk ka bazë tjetër ligjore për të vazhduar përpunimin e të dhënave.
- kur ju kundërshtoni përpunimin e të dhënave dhe KRK nuk ka interes legjitim për të vazhduar përpunimin e më tutjeshëm.
- të dhënave personale janë përpunuar në mënyrë të kundërligjshme.
- të dhënave personale duhet të fshihen për shkak të një detyrimi ligjor.

Pas marrjes së një kërkesë, KRK do të fshijë të dhënave nëse nuk përpunohen për një nga arsyet e mëposhtme:

- për ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit
- për përmbushjen e një detyrimi ligjor nga KRK
- për kryerjen e një detyre në interesin publik ose në ushtrimin e autoritetit zyrtar
- për shkaqe të interesit publik në sferën e shëndetit publik
- për qëllime arkivimi në interesin publik, ose për qëllime të kërkimit shkencor historik ose qëllime statistikore ose
- për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore.

Kur kërkesa juaj nuk është përmbushur për shkak të një prej arsyeve të mësipërme, ju do të informoheni për arsyen.

E drejta për të kufizuar përpunimin e të dhënave: Ju keni të drejtë të kufizoni përpunimin e të dhënave tuaja në rrethana të caktuara. Kufizimi i KRK-së nga përpunimi i të dhënave tuaja do të thotë se KRK do të vazhdojë të mbajë të dhënave tuaja, por do të ndalojë përpunimin e tyre, përveç nëse:

- Ju pranoni që ato të përpunohen
 - Përpunimi kërkohej në lidhje me një kërkesë ligjore.
- KRK do të kërkohej të kufizojë përpunimin e të dhënave tuaja personale në rrethanat e mëposhtme:
- kur ju e njoftoni KRK-në se të dhënave që mbanë për ju nuk janë të sakta. Nëse ndodh kështu, KRK do të ndalojë përpunimin e të dhënave derisa të siguron saktësinë e të dhënave.
 - kur të dhënave përpunohen për kryerjen e një detyre të interesit publik ose për shkak të interesave legjitime të KRK-së dhe ju keni kundërshtuar përpunimin e të dhënave. Në këto rrethana, përpunimi mund të kufizohet ndërkohë që KRK konsideron nëse interesat e saj të ligjshme nënkuptojnë se është e përshtatshme të vazhdohet me përpunimin e të dhënave.
 - kur të dhënave janë përpunuar në mënyrë të paligjshme.
 - kur KRK nuk ka më nevojë të përpunojë të dhënave, por ju duhen të dhënave në lidhje me një kërkesë ligjore.

E drejta e transferimit të të dhënave: Ju keni të drejtë të merrni të dhënave personale që ju keni dhënë KRK-së në një format të lexueshëm në formë elektronike dhe të strukturuar dhe të transmetoni të dhënave në një kontrollues tjetër të dhënave. Kjo e drejtë zbatohet në rrethanat e mëposhtme: kur i keni dhënë të dhënave tuaja KRK-së

- kur përpunimi kryhet sepse i keni dhënë KRK-së pëlqimin tuaj për ta bërë këtë
- kur përpunimi kryhet për të finalizuar kontratën e punës midis jush dhe KRK-së
- kur përpunimi kryhet me mjete të automatizuara.

- Ju nuk do të tarifoheni për ofrimin e këtyre të dhënave. Sipas kërkesës, KRK do t'i transmetojë të dhënat drejtpërdrejt te një organizatë tjetër nëse sistemet tona të TI janë në përputhje me ato të marrësit.

E drejta për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave: Ju keni të drejtë të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja në rrethana të caktuara. Kjo do të thotë që ju keni të drejtë të kërkonti që KRK të ndalojë përpunimin e të dhënave tuaja. Ju mund të kundërshtoni përpunimin aty ku përpunimi bëhet:

- në lidhje me interesat legjitime të KRK-së
- për kryerjen e një detyre në interesin publik
- në ushtrimin e autoritetit zyrtar ose
- për qëllime të profilizimit.

Aty ku ju kundërshtoni përpunimin e të dhënave, KRK do të ndalojë aktivitetin e përpunimit të kundërshtuar, përveç nëse: KRK mund të demonstrojë arsye bindëse legjitime për përpunimin e të dhënave që besohet të jetë më të rëndësishme sesa të drejtat tuaja ose

- Përpunimi kërkohet në lidhje me pretendimet ligjore të bëra nga ose kundër KRK-së.

E drejta për vendimarrjen e automatizuar individuale, duke përfshirë profilizimin:

Ju keni të drejtë të mos i nënshtroheni një vendimi të bazuar vetëm në një përpunim automatik, duke përfshirë profilizimin që prodhon efekte në lidhje me të ose e ndikon në mënyrë të ngjashme atë.

Megjithatë, paragrafi i lartëcekur nuk zbatohet në rrethanat e mëposhtme:

- kur është e nevojshme për të lidhur ose përmbushur një kontratë ndërmjet subjektit të të dhënave dhe një kontrolluesi të dhënash.
- kur autorizohet nga ndonjë ligj specifik
- kur ju keni dhënë pëlqimin në mënyrë të qartë.
- Në rrethanat ku përdorim të dhëna të kategorive të veçanta, për shembull, të dhënat për shëndetin tuaj, jetën seksuale, orientimin seksual, racën, origjinën etnike, bindjet politike, religjionin dhe anëtarësinë në sindikata, KRK do të sigurojë që një nga këto vlen për përpunimin: kur ju keni dhënë pëlqimin tuaj të qartë për përpunim ose
- Përpunimi është i nevojshëm për arsye të interesit të konsiderueshëm publik.

Si mund të na kontaktoni:

Nëse keni ndonjë pyetje rreth mbrojtjes së të dhënave të tuaja personale, ju lutem na dërgoni pyetjen në adresën elektronike mbrojtja_etedhenave@krk-ks.com ose në numrin e telefonit +383 38 222 345.

Tërheqja e pëlqimit:

Subjekti i të dhënave ka të drejtën të tërheqë pëlqimin e tij në çdo kohë dhe duhet të plotësoj Formularin e Tërheqjes së Pëlqimit, e cila mund të shkarkohet përmes web faqes. Pas plotësimit të formës, subjekti i të dhënave duhet ta dërgoj në posten elektronike mbrojtja_etedhenave@krk-ks.com